

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 8.6.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	5817
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 8.6.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.....	5817
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nr. 33839/11, datë 7.4.2016	Çështja Halimi dhe të tjerët kundër Shqipërisë (<i>ankimi nr. 33839/11</i>)	5818
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 58, datë 10.6.2016	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste në qarkun Vlorë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, për shkak të mbarimit mandatit të deputetit të z. Koço Kokëdhima.....	5822



VENDIM
Nr. 419, datë 8.6.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 484, DATË 10.6.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME DHE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE TË KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL DHE AVOKATURA E SHTETIT, TË MJEDISEVE NË GODINËN E ISH-HOTEL “DRINIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i fundit, i pikës 2, të vendimit nr. 484, datë 10.6.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Një pjesë e oborrit të brendshëm, me sipërfaqe 135.30 (njëqind e tridhjetë e pesë pikë tridhjetë) m², me numër pasurie 1/501, kalon në përgjegjësi administrimi të përbashkët të të tria institucioneve të përmendura në pikën 1, të vendimit në fuqi, për t’u përdorur prej tyre.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 427, datë 8.6.2016

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100, të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të shkronjës “b”, të pikës 6, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe

zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në vijim “AKPT”, organizohet dhe funksionon në përputhje me këtë vendim dhe me ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

2. AKPT-ja është person juridik publik, buxhetor, me përgjegjësi planifikimi, në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit urban, me seli në Tiranë.

3. AKPT-ja ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për zhvillimin urban, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të AKPT-së.

4. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit”, në përputhje me vendimin nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”, të ndryshuar.

5. Vula zyrtare e AKPT-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në pikën 2, të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar. Vula e AKPT-së prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AKPT-së

1. AKPT-ja është institucion me përgjegjësi planifikimi, në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, që e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. AKPT-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton veprimtarinë e saj dhe përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për zhvillimin urban.

3. Drejtori i përgjithshëm i AKPT-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



4. Zëvendës drejtori i përgjithshëm i AKPT-së, i cili është, njëkohësisht, edhe drejtor i një drejtorie, emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të AKPT-së.

5. AKPT-ja është institucion buxhetor, që financohet nga buxheti i shtetit, donacione të jashtme dhe burime të tjera të ligjshme. AKPT-ja siguron të ardhura edhe nga shërbimet e kryera prej saj ndaj palëve të tjera. Tarifat e këtyre shërbimeve përcaktohen sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

6. AKPT-ja administron fonde buxhetore dhe ato të siguruara nga shërbimet ndaj palëve të tjera, sipas rregullave dhe parimeve të sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

7. Struktura dhe organika e AKPT-së miratohet me urdhër të Kryeministrit.

III. PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E AKPT-së

1. AKPT-ja, në zbatim të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, ka përgjegjësi të natyrës bashkërenduese. Ajo bashkërendon proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit e zhvillimit të territorit dhe mbështet bashkërendimin vertikal e horizontal ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit. Në kuadër të bashkërendimit të veprimtarive dhe punës së institucioneve në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, ajo:

a) zhvillon mbledhje, takime dhe konsultime me autoritetet përgjegjëse kombëtare e vendore të planifikimit të territorit;

b) harton dhe zbaton politika që lehtësojnë, nxisin dhe mbështesin bashkëpunimin e bashkërendimin e veprimtarive në çdo nivel;

c) bashkëvepron dhe shkëmben të dhëna me këto autoritete, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme kombëtare e vendore në fushën e planifikimit të territorit;

ç) ofron asistencë, këshillim, të dhëna dhe informacion, me synim garantimin e standardeve dhe të cilësisë në trajtimin e çështjeve të rëndësishme kombëtare e vendore në fushën e planifikimit të territorit.

2. AKPT-ja udhëheq, koordinon dhe ndërlik veprimtaritë për modernizimin e modelit të planifikimit dhe promovimin e praktikave novatore në arkitekturë e planifikim. Në këtë kuadër, ajo:

a) përpunon, nxit, zbaton dhe përfshihet në nisma për përmirësimin e modernizimin e modelit

të planifikimit të territorit;

b) organizon, ndjek, zbaton, merr pjesë në projekte pilot apo aktivitete të ngjashme, brenda dhe jashtë vendit, që synojnë promovimin e modeleve novatore të planifikimit të territorit dhe praktikave të reja në arkitekturë e planifikim;

c) kujdeset për ndërlidhjen ndërmjet projekteve apo veprimtarive që paraqesin risi në fushën e planifikimit dhe ekspertizës vendase apo të huaj, si dhe për zhvillimin e zbatimin e këtyre projekteve e veprimtarive.

3. AKPT-ja është përgjegjëse për informimin e proceseve të përmirësimit të legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Ajo i propozon Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, rishikimin e akteve apo hartimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, apo edhe hartimin e instrumenteve të reja ligjore në fushën e planifikimit dhe arkitekturës.

4. AKPT-ja është përgjegjëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e bazës së integruar të të dhënave të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në këtë kuadër, AKPT-ja:

a) organizon, administron, përditëson dhe mirëmban Regjistrin e Integruar të Territorit;

b) monitoron, në vazhdimësi, përputhshmërinë e akteve të botuara në Regjistrin e Integruar të Territorit me ligjet dhe dokumentet e planifikimit në fuqi dhe ofron propozime e asistencë për garantimin e përputhshmërisë;

c) harton, përditëson, përmirëson në vazhdimësi dhe shpërndan standarde teknike të administrimit të Regjistrin të Integruar të Territorit;

ç) u ofron asistencë autoriteteve të planifikimit për mënyrën e regjistrimit dhe të administrimit të të dhënave në Regjistrin e Integruar të Territorit.

5. AKPT-ja është përgjegjëse për informimin e publikut për proceset e planifikimit të territorit, si dhe për nxitjen e pjesëmarrjes së tij gjatë proceseve të hartimit e zbatimit të dokumenteve të planifikimit.

6. AKPT-ja angazhon njësitë e saj përgjegjëse për të siguruar standardet ligjore, teknike dhe metodologjike të fushës së planifikimit e zhvillimit. Në këtë kuadër, ajo:

a) siguron që hartimi i dokumenteve të planifikimit të territorit, në nivel qendror dhe vendor, të jetë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.



107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, nëpërmjet ofrimit të ndihmës teknike për autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit. Masat që ndërmerr AKPT-ja për këtë qëllim, përfshijnë:

i) ofrimin e të dhënave elektronike bazë dhe normave teknike të planifikimit të territorit që duhet të shfrytëzohen gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit, në nivel kombëtar e vendor;

ii) zhvillimin e trajnimeve për përdorimin e të dhënave elektronike bazë dhe normave teknike të planifikimit të territorit para se të fillojë hartimi i dokumenteve të planifikimit;

iii) vlerësimin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit në shqyrtim me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe planet e tjera kombëtare, në bazën e parimit të hierarkisë së dokumenteve të planifikimit, si dhe kontrollin e tyre me të dhënat elektronike bazë e normat teknike të planifikimit.

b) përgatit dhe boton manuale metodologjike për planifikimin e territorit;

c) siguron përgatitjen e standardeve teknike të administrimit të Regjistrimit të Integruar të Territorit dhe ofron ndihmë për institucionet, për garantimin e cilësisë maksimale në regjistrimin dhe administrimin e pavarur të këtij regjistri, në përputhje me parashikimet e pikës 4, të kreut III, të këtij vendimi.

7. AKPT-ja është përgjegjëse për përgatitjen e studimeve për Sistemin e Integruar të Planifikimit në Republikën e Shqipërisë dhe propozimet për ministrin përgjegjës për zhvillimin urban, Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Këshillin e Ministrave për masat për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe për procese e veprimtari në lidhje me planifikimin e zhvillimin e territorit. Për këtë qëllim, AKPT-ja kryen veprimtari kërkimore, analiza dhe studime në funksion të propozimit, mbështetjes apo informimit të proceseve vendimmarrëse dhe të përmirësimit të politikave në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

8. AKPT-ja kujdeset që produktet e veprimtarisë kërkimore, analizuere e studimore, të kryera në përmbushje të detyrimeve të pikës 7, të kreut III, të këtij vendimi, apo si rezultat i praktikës dhe veprimtarisë së saj, t'i vërë në dispozicion të zhvillimit të qëndrueshëm urban në Shqipëri. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKPT-së, dokumente të caktuara mund të botohen në

formën e studimeve, broshurave apo materialeve didaktike, si dhe të vihen në dispozicion të trajnimit e aftësimit profesional të profesionistëve të planifikimit dhe zhvillimit urban apo në dispozicion të publikut, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të AKPT-së. Rregulla më të detajuara për organizimin e kësaj veprimtarie dhe për strukturat përgjegjëse të AKPT-së përcaktohen në rregulloren e funksionimit të saj, të miratuar sipas pikës 6, të kreut II, të këtij vendimi.

9. AKPT-ja, çdo vit, harton Raportin Monitorues të Zbatimit të Qëllimeve dhe të Objektivave, të deklaruara në Planin e Përgjithshëm të Territorit dhe planet e detajuara për zona me rëndësi kombëtare. Njësia përgjegjëse e AKPT-së për hartimin e këtij raporti dhe afati brenda të cilit ai përgatitet përcaktohen në rregulloren e funksionimit të AKPT-së, të miratuar sipas pikës 6, të kreut II, të këtij vendimi.

IV. MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL TË PROFESIONISTËVE TË PLANIFIKIMIT

1. AKPT-ja është përgjegjëse për zhvillimin e trajnimeve për profesionistët e sektorit publik e privat, që ushtrojnë veprimtari profesionale në fushën e planifikimit të territorit, për zbatimin e ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore që lidhen me të.

2. AKPT-ja zhvillon trajnime në vazhdimësi për zhvillimin profesional dhe përditësimin e vazhdueshëm të dijeve të profesionistëve të planifikimit të territorit, të përcaktuar në nenin 14, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

3. Me qëllim kualifikimin profesional fillestar të profesionistëve të rinj dhe zhvillimin profesional vazhdueshëm të profesionistëve aktivë të planifikimit të territorit, AKPT-ja organizon programe trajnimi fillestar dhe vazhdueshëm, duke vënë në zbatim metodologji trajnuese moderne të të mësuarit nëpërmjet punës dhe të orientuara nga praktika. Sipas rastit, AKPT-ja, nëpërmjet strukturave përkatëse, integron këto programe me veprimtarinë e saj kërkimore, studimore e analizuere për informimin e vendimmarrjes, politikave dhe legjislacionit të planifikimit. Për zbatimin e kësaj pike, AKPT-ja bashkëpunon me ekspertë vendas e të huaj, institucione të arsimit të lartë vendase apo të huaja, publike apo private, si dhe me organizata



të tjera partnere. Rregulla më të detajuara për organizimin e programeve të tilla, përmbajtjen dhe procedurat miratohen nga drejtori i përgjithshëm.

4. AKPT-ja zhvillon trajnime për përdorimin e të dhënave elektronike bazë e normave teknike të planifikimit të territorit përpara se të fillojë hartimi i dokumenteve të planifikimit, si dhe për përmirësimin e cilësive profesionale e teknike të autoriteteve të planifikimit.

5. AKPT-ja, me qëllim ofrimin e mundësive të aftësimit praktik për studentët dhe profesionistët e rinj të fushave që lidhen me planifikimin e territorit, mbështet organizimin, çdo vit, të programeve të praktikave të punës, të organizuara nga ministria përgjegjëse për miratimin e Planit Kombëtar të Praktikave të Punës.

6. Përveç parashikimeve të pikës 5, më sipër, AKPT-ja organizon e zhvillon edhe programe të tjera praktikash profesionale për studentët e fushave që lidhen me planifikimin e territorit, duke zbatuar metodologji të të mësuarit nëpërmjet punës. Rregulla të detajuara për kohëzgjatjen e këtyre programeve, numrin e përfituesve dhe kriteret që duhet të plotësojnë ata, bashkëpunëtorët, kushtet dhe rregullat e praktikave profesionale përcaktohen për çdo rast, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm.

7. AKPT-ja, me qëllim kualifikimin profesional të profesionistëve të planifikimit në sektorin publik apo privat dhe studentëve apo profesionistëve të rinj të kësaj fushe, mbështet shkëmbimin e dijeve dhe të ekspertizës me profesionistë të planifikimit, akademikë, institucione partnere dhe institucione akademike të huaja.

V. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL ME PALËT E TRETË DHE ATO NDËRKOMBËTARE

1. AKPT-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të marrë nga organet e tjera shtetërore, qendrore dhe vendore, të gjithë ndihmën, informacionin, si dhe të dhënat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të saj. Institucionet shtetërore kanë detyrim të bashkëpunojnë me AKPT-në, të shkëmbejnë të dhëna e të krijojnë të gjitha lehtësitë për përmbushjen e qëllimeve dhe funksioneve gjatë veprimtarisë së saj.

2. AKPT-ja, në përmbushje të detyrave të saj, bashkëpunon dhe bashkërendon punën me institucionet e tjera, në nivel qendror e lokal, dhe i

ndihmon ato, sipas përgjegjësisë të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe në këtë vendim.

3. AKPT-ja bashkëpunon me organizata të huaja e ndërkombëtare, që synojnë mbështetjen e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, dhe me agjenci partnere të shteteve të tjera. Ajo nxit, lehtëson dhe mbështet bashkëpunimin ndërkombëtar të autoriteteve kombëtare e vendore të planifikimit të territorit.

4. AKPT-ja, nëpërmjet njësisë përkatëse të jetësimit të prioritetëve, bashkëpunon me konsulentë vendas apo të huaj, institucione publike, institucione arsimore publike apo private, vendase ose të huaja, si dhe me organizata të tjera partnere për përmirësimin e modernizimin e modelit të planifikimit të territorit, si dhe për organizimin dhe zbatimin e projekteve të ndryshme në fushën e planifikimit, urbanistikës dhe arkitekturës.

5. Për qëllime të informimit të publikut dhe përfshirjes së tij në procese konsultuese në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, AKPT-ja bashkëpunon me institucione, organizata vendase dhe të huaja, me grupet e interesit, shoqërinë civile dhe median.

6. Për qëllime të aftësimit praktik dhe kualifikimit profesional të studentëve, profesionistëve të rinj dhe profesionistëve aktivë të zhvillimit e planifikimit të territorit, AKPT-ja bashkëpunon me profesionistë të fushës, institucione shtetërore, institucione arsimore, publike apo private, vendase apo të huaja, si dhe me organizata partnere, vendase dhe të huaja.

VI. INFORMIMI DHE KONSULTIMI I PUBLIKUT

1. AKPT-ja është përgjegjëse për informimin e publikut për proceset e planifikimit të territorit. Për këtë qëllim, ajo:

a) ofron informacion për publikun, nëpërmjet mjeteve të komunikimit publik, publikimeve, botimeve, konferencave dhe aktiviteteve të ndryshme informuese;

b) përditëson, në vazhdimësi, informacionin e disponueshëm për publikun në faqen zyrtare në internet;

c) organizon dhe zbaton veprimtari, nisma e projekte për informimin e publikut për proceset e planifikimit të territorit;

ç) siguron një mjedis të posaçëm për komunikimin me publikun dhe në shërbim të tij.



2. AKPT-ja është përgjegjëse për inkurajimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes së publikut gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit. Për këtë qëllim, ajo:

a) kujdeset për informimin e grupeve të interesit dhe publikut për këto procese;

b) organizon dhe zbaton veprimtari për konsultimin e grupeve të interesit dhe publikut, me qëllim përthithjen e mendimeve gjatë proceseve të hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit;

c) shërben si një platformë ndërlidhëse ndërmjet ekspertizës vendase, grupeve të interesit e publikut dhe institucioneve qendrore në fushën e planifikimit.

3. Veprimtaritë konsultuese, në kuptim të pikës 2 më sipër, përfshijnë, por pa u kufizuar, tryezat e konsultimit publik, debatet publike, konferencat, seancat informuese dhe dëgjimore, me pjesëmarrjen e ekspertëve, akademikëve, grupeve të interesit, organizatave vendase dhe të huaja, si dhe shoqërisë civile e publikut.

4. Për qëllime të informimit të publikut dhe përfshirjes së tij në procese konsultuese në fushën e planifikimit, AKPT-ja bashkëpunon me organizata vendase, të huaja, ndërkombëtare, me median e shkruar dhe elektronike, institucione arsimore, publike apo private, grupe të interesit dhe shoqërinë civile.

VII. REKRUTIMI I PUNONJËSVE TË AKPT-së

1. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKPT-së rregullohen sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Punonjësit e AKPT-së, me përjashtim të punonjësve mbështetës, duhet të kenë arsimin e lartë profesional të nevojshëm, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe të plotësojnë kërkesat e veçanta, që përcaktohen nga drejtori i përgjithshëm.

VIII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Urdhri për miratimin e rregullores së funksionimit të AKPT-së miratohet brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi përballohen nga buxheti i shtetit për vitin 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

3. Deri në ristrukturimin e AKPT-së dhe rekrutimin e stafit të nevojshëm, përgjegjësitë e parashikuara në këtë vendim kryhen nga njësitë dhe stafi ekzistues.

4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 428, datë 8.6.2016

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE PËR HARTËN DIXHITALE TË VENDDEPOZITIMEVE TË MBETJEVE URBANE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane (shkurtimisht “HDVMU”).

2. Termat e përdorur në këtë vendim kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ligjin nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjin nr. 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

3. Sistemi i bazës së të dhënave të hartës dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane realizohet në përputhje me standardet e parashikuara në ligjin nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, dhe përmban të dhëna, për:

a) llojin e venddepozitimit;

b) popullsinë së cilës i shërben ky venddepozitim;

c) sasinë e mbetjeve të depozituara në vit;

ç) distancat nga:

i) vendbanimet;

ii) rrugët nacionale;

iii) brigjet ujore;



- iv) burimet ujore;
- v) aeroportet;
- vi) shtëpitë;
- vii) hekurudhat;
- viii) varrezat;
- ix) qendrat e qytetit.

d) fotografitë e venddepozitimit dhe të zonës përreth;

dh) dokumente të planifikimit;

e) të dhëna hapësinore/hartografike në lidhje me rajonin e mbetjeve dhe bashkitë ku ndodhet venddepozitimi.

4. Institucioni administrues i sistemit të hartës dixhitale të venddepozitimeve të mbetjeve urbane është Ministria e Zhvillimit Urban nëpërmjet strukturës përkatëse që mbulon çështjet e HDVMU-së.

5. Të dhënat parësore dhe dytësore të hartës janë, si më poshtë vijon:

5.1 Të dhënat parësore përfshijnë:

- a) shtrirjen fizike të venddepozitimit në territor;
- b) sipërfaqen e venddepozitimit;
- c) distancat nga zona me interes të veçantë;
- ç) foto të venddepozitimit, si dhe të zonës përreth;

d) pikat në hartë.

5.2 Të dhënat dytësore përfshijnë:

a) hartat dhe ortofotot për të gjithë territorin e Shqipërisë;

b) rrugët nacionale;

c) linjat hekurudhore;

ç) kufijtë administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore (NJVQV);

d) dokumentet e planifikimit të vëna në dispozicion nga organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore përkatëse;

dh) sasitë e mbetjeve të depozituara në venddepozitim;

e) numrin e popullsisë të cilës i shërben venddepozitimi ekzistues.

6. Dhënësit e informacionit për hartën janë përdoruesit e thjeshtë, sipas rolit që kryejnë në hartë, si:

a) Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit, në Ministrinë e Zhvillimit Urban, dhe Gjeoportali Kombëtar ASIG, në nivel kombëtar;

b) organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore, në nivel vendor.

6.1 Informacioni i dhënë nga Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit përfshin:

a) caktimin e pikave të venddepozitimeve në hartë;

b) përcaktimin e sipërfaqeve të venddepozitimeve në hartë;

c) reflektimin e zhvillimeve të reja bazuar në planet kombëtare.

6.2 Informacioni i dhënë nga organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet shkresave zyrtare dhe vizitave në terren përfshin:

a) numrin e popullsisë;

b) dokumente planifikimi;

c) të dhëna statistikore dhe historike mbi mbetjet.

6.3 Informacioni i dhënë nga Gjeoportali Kombëtar ASIG, përfshin:

a) informacion mbi kufijtë territorialë;

b) harta dhe ortofoto.

7. Baza e të dhënave e hartës dixhitale shkëmben informacion, nëpërmjet shërbimeve *online* të kërkimit, shikimit, shkarkimit dhe transformimit me sistemin e Gjeoportalit Kombëtar të ASIG-ut, sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

8. Subjektet e interesuara kanë mundësi të marrin informacionin e afishuar në hartë dhe të bëjnë komente mbi të, por jo të kryejnë përditësime.

9. Baza e të dhënave e hartës dixhitale ka dy nivele përdoruesish:

a) administrator;

b) përdorues.

10. Subjektet e interesuara për hartën dixhitale, janë:

a) qytetarët, për qëllime informimi;

b) zhvilluesit dhe investitorë, për qëllime informimi e investimi;

c) organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për qëllime informimi e planifikimi;

ç) institucionet qendrore, për qëllime informimi e planifikimi.

11. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**VENDIM**

Nr. 431, datë 8.6.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE,
TË DOKUMENTACIONIT,
PROCEDURAVE DHE TË MASËS PËR
PËRFITIMIN E PAGESËS SË AFTËSISË
SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT
PERSONAL DHE TË STRUKTURAVE
PËRGJEGJËSE E TË DETYRAVE TË
TYRE NË ZONAT PILOT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, nenit 42, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. SUBJEKTET PËRFITUESE**

1. Modeli bio-psiko-social i vlerësimit të aftësisë së kufizuar do të pilotohet për një periudhë 6-mujore, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, nëpërmjet përdorimit të Regjistrat Elektronik Kombëtar, në njësitë administrative nr. 6 dhe nr. 7, të qarkut të Tiranës.

2. Në vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar do të përfshihen:

a) individët që kërkojnë të vlerësohen për herë të parë;

b) individët që kërkojnë të rivlerësohen, të cilët kanë përfutuar pagesë të aftësisë së kufizuar sipas legjislacionit në fuqi.

II. KRITERET E PËRFITIMIT DHE DOKUMENTACIONI I PRANIMIT

1. Për marrjen e përfitimeve të aftësisë së kufizuar duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:

a) personi të ketë një gjendje mjekësore të vërtetuar të një dëmtimi fizik, mendor, intelektual apo shqisor të lehtë mesatar, të rëndë ose të thellë;

b) të vërtetohen kufizime të lehta, mesatare, të rënda ose të thella, të shkaktuara nga dëmtimi;

c) të vërtetohen kufizime mesatare, të rënda, të thella për të kryer veprimtari domethënëse të jetesës së përditshme, të përshtatshme për moshën e personit dhe për të marrë pjesë në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike;

ç) personi të përjetojë kufizime të konsiderueshme mjedisore dhe qendrimore, të cilat ndikojnë në aftësinë për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe pjesëmarrje të barabartë në shoqëri;

d) personi të jetë mbi moshën 2 vjeç;

dh) personit nuk i ka lindur e drejta për t'u trajtuar me pension sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, para datës së intervistës së vlerësimit;

e) personi nuk ka qenë në marrëdhënie pune, para lindjes të së drejtës për komisionim, dhe nuk përfiton nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Dokumentacioni për përfitimin e aftësisë së kufizuar përfshin:

a) kërkesën/formularin e aplikimit;

b) formularin e plotësuar nga mjeku i familjes;

c) formularin e plotësuar nga mjeku specialist /Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor (QKSHM);

ç) kopje të kartës së identitetit ose certifikatë personale.

3. Dokumentet e përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu, dorëzohen/postohen pranë zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë.

III. VLERËSIMI BIO-PSIKO-SOCIAL

1. Procesi i mbështetur në modelin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar përfshin vlerësimin mjekësor të aplikuesit nga mjeku i familjes dhe nga mjeku specialist/QKSHM-ja, një intervistë me aplikuesin në Zyrën Rajonale të Vlerësimit të Personave me Aftësi të Kufizuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë të kufizuar, me mjekë dhe punonjës socialë, verifikimin e informacionit të marrë dhe kontrollin vjetor mjekësor.

2. Vlerësimi bio-psiko-social i aftësisë së kufizuar dhe nivelit të kufizimeve funksionale bëhet në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar mbi Funkcionimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ky vlerësim përfshin faktorët që dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët. Udhëzuesit për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar



për të rriturit dhe fëmijët miratohen nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë.

3. Pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë ngrihet zyra e administrimit të procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

4. Pranë zyrës së administrimit të procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar krijohet komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar në nivel rajonal, i cili përbëhet nga punonjës me kohë të plotë dhe ka në përbërje së paku një mjek dhe një punonjës social/psikolog, të trajnuar për modelin bio-psiko-social të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar. Komisioni kryesohet nga përgjegjësi i zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe ka këto detyra:

a) hedhjen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të të dhënave të aplikuesit;

b) vlerësimin dhe shqyrtimin e dosjeve të paraqitura për vlerësim/rivlerësim;

c) verifikimin dhe shkëmbimin e informacionit elektronik me rrjetin e institucioneve të tjera të kujdesit shëndetësor, të arsimit, punësimit e formimit profesional, sigurimeve shoqërore, tati-meve, strukturave përgjegjëse pranë pushtetit vendor, si edhe institucioneve të tjera, nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar dhe, kur nuk është e mundur, manualisht/zyrtarisht;

ç) caktimin e datës së intervistës dhe njoftimin e kërkuarit ose kthimin e dosjes për plotësim kur ka mungesë dokumentacioni;

d) organizimin dhe kryerjen e intervistës brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumenteve të aplikimit apo në një afat më të shkurtër për rastet për të cilat kërkohet procedurë e përsheptuar;

dh) përgatitjen e rekomandimeve për shërbime të tjera dhe marrjen e vendimit për përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar;

e) njoftimin e kërkuarit për vendimmarrjen dhe pajisjen me dokumentin përkatës që përcakton aftësinë e kufizuar;

ë) mbajtjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave e të dokumentacionit të kërkuarve e të përfituesve të aftësisë së kufizuar, elektronikisht dhe fizikisht.

5. Personat, të cilët kanë një shfaqje të menjëhershme të një sëmundjeje të rëndë ose një humbje të plotë e të menjëhershme të aftësive funksionale për të kryer veprimtari të jetesës së

përditshme, mund të kualifikohen për procesin e përsheptuar të vlerësimit, i cili do të kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumenteve të aplikimit.

6. Drejtori i Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror nxjerr vendimin përfundimtar për të gjithë përfituesit e aftësisë së kufizuar dhe ia përcjell bashkisë:

a) për zbatimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit;

b) për të kryer veprimet financiare për kryerjen e pagesës për përfituesit e aftësisë së kufizuar.

7. Administratori shoqëror pranë organeve të pushtetit vendor ka këto përgjegjësi lidhur me menaxhimin e rasteve të personave me aftësi të kufizuara:

a) hartimin e një plani individual të përvitshëm të shërbimeve, mbështetur në rekomandimet e komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit;

b) kryerjen e vizitave në mjedisin ku jeton individi, jo më pak se dy herë në vit;

c) informimin e zyrës së vlerësimit mbi ndryshimin e gjendjes së personit me aftësi të kufizuara;

ç) informimin e individëve për shërbimet shoqërore ekzistuese nën juridiksionin e bashkisë /njësisë administrative në territorin e së cilës është banor individi;

d) informimin e individëve për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë për vlerësim/rivlerësim të aftësisë së kufizuar;

dh) informimin e familjarëve për të drejtat e personit me aftësi të kufizuara për t'u përfshirë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore;

e) monitorimin dhe mbështetjen e shërbimit të asistencës personale;

ë) evidentimin, raportimin dhe referimin e rasteve të abuzimit e të neglizhencës.

8. Monitorimi i punës së zyrave rajonale për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe trajnimet e stafit të tyre realizohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.

IV. PËRFTITIMET NË PAGESA DHE SHËRBIME

1. PAGESA për shkak të aftësisë së kufizuar është një pagesë mujore e cila jepet në muajin pasardhës nga data e vendimit për përfitime, me qëllim përmbushjen e nevojave elementare, të lidhura me aftësinë e kufizuar, e cila përfitohet nga personat të cilët janë deklaruar si të tillë me vendim të



komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

2. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar është 150% e shumës së pensionit social, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar indeksohet sa herë indeksohet pensioni social/në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

a) personat mbi 18 vjeç me kufizime të lehta referohen për të përfutuar shërbime/punësim ose, në mungesë të tyre, përfitojnë 60% të pagesës bazë, të përcaktuar në pikën 2;

b) personat mbi 18 vjeç me kufizime mesatare përfitojnë 80% të pagesës bazë, të përcaktuar në pikën 2;

c) personat mbi 18 vjeç me kufizime të thella përfitojnë 100% të pagesës bazë, të përcaktuar në pikën 2;

ç) personat mbi 18 vjeç me kufizime të rënda përfitojnë 120% të pagesës bazë, të përcaktuar në pikën 2;

d) fëmijët me kufizime të lehta referohen për të përfutuar shërbime ose në mungesë të tyre përfitojnë 75% të shumës së përcaktuar për personat madhorë me kufizime të lehta, të përcaktuar në shkronjën “a”, të kësaj pike;

dh) fëmijët me kufizime mesatare përfitojnë 75% të shumës së përcaktuar për personat madhorë me kufizime mesatare, të përcaktuar në shkronjën “b”, të kësaj pike;

e) fëmijët me kufizime të rënda përfitojnë 75% të shumës që përfitojnë personat madhorë me kufizime të rënda, të përcaktuar në shkronjën “c”, të kësaj pike;

ë) fëmijët me kufizime të thella përfitojnë 75% të shumës që përfitojnë personat madhorë me kufizime të thella, të përcaktuar në shkronjën “ç”, të kësaj pike.

3. Niveli i pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit në përputhje me udhëzimet e miratuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

4. Pagesat për personat me aftësi të kufizuara kryhen përmes shërbimeve bankare ose Postës Shqiptare.

5. Pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar ndërpriten, kur:

a) përfituesi nuk ka dorëzuar raportin vjetor mjekësor deri në 30 ditë kalendarike pas datës së përcaktuar për dorëzimin e tij;

b) përfituesi nuk ka ndjekur procedurat e rivlerësimit deri në 30 ditë kalendarike pas datës së përcaktuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar;

c) verifikohet mashtrimi apo shpërdorimi dhe nisnin procedurat për kthimin e të gjitha shumave të përfituara padrejtësisht;

ç) zyrat rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit raportojnë për mungesën e bashkëpunimit nga ana e përfituesve, të cilët janë rekomanduar për t'u punësuar dhe/ose për të mbajtur një vend pune apo kanë refuzuar deri në dy herë ofertat e përshtatshme të punës nga zyrat e punës;

d) përfituesi ka qëndruar jashtë vendit më shumë se 6 muaj, me përjashtim të personave e të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtarë, si dhe të rasteve të përfituesve të cilët ndodhen jashtë shtetit shqiptar për qëllime kurimi apo rehabilitimi.

6. Fëmijët e moshës mbi 3 vjeç dhe të rriturit, të cilët janë vlerësuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit se kanë nevojë për paketë higjieno-sanitare në rastet kur kanë dëmtime të rënda ose të thella të lëvizshmërisë dhe që shfaqin mungesë vetëpërmbytjeje urinare apo defekimi, do të pajisen me një paketë higjieno-sanitare, e cila deri në momentin që do të administrohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor përmes rrjetit farmaceutik, do të jepet në vlerë monetare, e cila përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

7. Fëmijët e moshës mbi 3 vjeç dhe të rriturit, të cilët janë vlerësuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit se kanë nevojë për karrige me rrota në rastet kur kanë dëmtime të rënda ose të thella të lëvizshmërisë, mund të pajisen me karrige me rrota, të cilat administrohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor, përmes rrjetit farmaceutik.

8. Fëmijët e moshës mbi 3 vjeç dhe të rriturit, të cilët janë vlerësuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit se kanë vështirësi në komunikim, mund të pajisen me pajisje të teknologjisë mbështetëse për komunikim, të cilat administrohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor, përmes rrjetit farmaceutik.



9. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e mesëm, të lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përfitojnë pagesë në masën 150% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi. Në rastet kur janë anëtarë të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike përfitojnë pagesë, në masën 200% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi.

10. Janë në kushtet e përfitimit të ndihmës personal që përmbushin kushtet e mëposhtme:

a) kanë kufizime të rënda ose të thella të aftësisë funksionale për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme të përshtatshme për moshën dhe për të marrë pjesë në jetën sociale, ekonomike dhe politike të shoqërisë;

b) kanë nevojë për ndihmë për të kryer veprime bazike të lidhura me jetesën e përditshme dhe për pjesëmarrje në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike, sipas përcaktimeve të komisionit shumë-disiplinor të vlerësimit;

c) përfituesit e pagesave për shkak të aftësisë së kufizuar, të cilëve u është ndërprerë pagesa e aftësisë së kufizuar pas periudhës 2-vjeçare të punësimit, nëse përmbushin kriteret e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike.

11. Shkalla e nevojës për shërbimet e ndihmës personal, gjithëpërfshirëse apo të herëpashërshme, përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

12. Ndihmësit personalë përzgjidhen nga përfituesit, kujdestari ligjor/prindi ose përmes procesit të vendimmarrjes së mbështetur dhe mund të ofrohen nga anëtarë të familjes, të afërm të përfituesit ose familjes, përfaqësues ligjorë ose agjenci të specializuara, të regjistruara dhe të licencuara.

13. Ndihmësi personal, për të ofruar shërbimet e ndihmës personale, duhet të provojë vendbanimin e tij në Shqipëri brenda së njëjtës bashki, aftësinë mendore dhe fizike për të ofruar këto shërbime, që nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë dhe që ka marrë trajnimin e nevojshëm.

14. Shërbimet e ndihmës personal rregullohen përmes një kontrate ndërmjet marrësit të shërbimeve ose përfaqësuesit ligjor dhe ofruesit të shërbimit.

15. Pagesat për shërbime të ndihmës personal lidhen me pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar dhe indeksohen çdo vit.

16. Shuma e pagesës për shërbime gjithëpërfshirëse është 120% e pagesës bazë të aftësisë së kufizuar.

17. Shuma e pagesës për shërbime të herëpashërshme është 80% e pagesës bazë të aftësisë së kufizuar.

18. Ndihmësit personalë, që ofrojnë shërbime të ndihmës personal për më shumë se një përfitues, marrin një shtesë prej 50% të shumave përkatëse për çdo përfitues të shtuar.

19. Pagesat për shërbime të ndihmës personal jepen në muajin pasardhës pas vendimit të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit. Pagesa kryhet përmes shërbimeve bankare ose Postës Shqiptare.

20. Kanë të drejtë të përfitojnë shërbime të përkthimit të gjuhës së shenjave nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) personat që kanë 100% humbje të dëgjimit, të provuar me dokumente shoqëruese mjekësore;

b) personat që përdorin gjuhën e shenjave në komunikimin e përditshëm, të verifikuar gjatë intervistës me komisionin shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;

c) kur kjo përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

V. PROCEDURA E ANKIMIMIT

1. Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit në rastet e refuzimit të plotë apo të pjesshëm të aplikimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar. Ankimimi bëhet me shkrim brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të refuzimit nga Zyra Rajonale e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

2. Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së përgjigjes nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.

3. Aplikuesi ka të drejtë të bëjë ankimim pranë Gjykatës Administrative në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

4. Në rastet kur kërkesa pranohet, personit do t’i lindë e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji



pasardhës nga data e marrjes së vendimit për refuzim nga komisioni ose sipas përcaktimeve në vendimin e gjykatës.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Nuk i nënshtrohen procedurës së vlerësimit në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi përfituesit ekzistues, sipas:

a) vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të cilët janë të verbër, invalidë pune, si edhe të verbrit, të cilëve u ka lindur e drejta për t’u trajtuar me pension pleqërie/social sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pikave 1 dhe 2, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara”, të ndryshuar, të cilëve u ka lindur e drejta për t’u trajtuar me pension pleqërie/social sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) pikës 1, të vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik e tetraplegjik”, të ndryshuar.

2. Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të nxjerrë udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimit dhe formatet standard të aplikimit, vlerësimit dhe përcaktimit të aftësisë së kufizuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 shtator 2016.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 432, datë 8.6.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 299, DATË 8.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË TREGTIMIT TË BARNAVE E TË KLASIFIKIMIT TË TYRE NË REPUBLIKËN SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 5, e 12, pika 3, të ligjit nr.

105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “a”, e ndarjes “A”, të nenit 3, të vendimit nr. 299, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, riformulohet, si më poshtë vijon:

“a) Certifikatën e Produktit Farmaceutik, sipas modelit të rekomanduar nga OBSH-ja, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vërtetohet se bari është i pajisur me autorizimin për tregtim dhe qarkullon në vendin referent. Certifikata e Produktit Farmaceutik duhet të jetë e vlefshme në kohën e aplikimit dhe, në rastet kur kjo nuk specifikohet, të jetë lëshuar jo më parë se 12 muaj nga data e dorëzimit. Kjo certifikatë duhet të jetë dokument origjinal, zyrtar ose çdo formë tjetër zyrtare, sipas legjislacionit të vendit që e ka lëshuar këtë certifikatë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 434, datë 8.6.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1353, DATË 10.10.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR PARAQITJEN E KËRKESËS, MBAJTJEN DHE PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIK, SI DHE TË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË ZVOGËLIMIT TË SIPËRFAQES E TË VËLLIMIT TË FONDIT PYJOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, date 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1353, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë vendimin bëhen ndryshimet e mëposhtme:



a) emërtimi “organe të qeverisjes vendore” zëvendësohet me “bashki”;

b) emërtimi “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me “Ministria e Mjedisit”;

c) emërtimi “Drejtori Rajonale e Shërbimit Pyjor” zëvendësohet me “struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki”;

ç) termi “pyje komunale” zëvendësohet me “pyje bashkiake”.

2. Pas shkronjës “c”, të pikës 5, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor nga ana e kryetarit të bashkisë, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore, e cila do t'i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor.”.

3. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Ministria, pas depozitimit të kërkesës, i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki identifikimin e ngastrave e të nënngastrave të kërkuara dhe hartimin e raportit teknik për to, brenda 1 jave nga data e marrjes së kërkesës. Ky raport i përcillet ministrisë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data që ajo e ka kërkuar.”.

4. Pika 11 ndryshohet si më poshtë vijon:

“11. Vlera e sipërfaqes pyjore të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga kërkuesi para hyrjes në fuqi të aktit të miratimit, të përmendur në shkronjat “a”, “b” e “c”, të pikës 8, të këtij vendimi, dhe derdhet në llogarinë bankare të bashkisë, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore e cila do t'i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor.”.

5. Pika 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

“16. Kur kërkesa bëhet sipas përcaktimit të pikës 14, ajo shqyrtohet nga Ministria e Mjedisit brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Pas këtij afati ajo quhet e miratuar. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe ministria bëjnë përditësimet në kadastrën e pyjeve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 435, datë 8.6.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1374, DATË 10.10.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE, QË NDIQEN PËR HEQJEN, SHTIMIN DHE NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË FONDIT KULLOSOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1374, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë vendimin bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) emërtimi “organe të qeverisjes vendore” zëvendësohet me “bashki”;

b) emërtimi “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohet me “Ministria e Mjedisit”;

c) emërtimi “Drejtori Rajonale e Shërbimit Pyjor” zëvendësohet me “struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki”;

ç) termi “kullotë komunale” zëvendësohet me “kullotë bashkiake”.

2. Pas shkronjës “c”, të pikës 6, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi kullosor nga ana e kryetarit të bashkisë, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja kullosore e cila do t'i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi kullosor.”.

3. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Ministria, pas depozitimit të kërkesës, i kërkon strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, identifikimin e ngastrave dhe të nënngastrave të kërkuara dhe hartimin e raportit teknik për to, brenda 1 jave nga marrja e kërkesës. Ky raport i përcillet ministrisë brenda 10 ditëve nga data që ajo e ka kërkuar.”.



4. Pika 12 ndryshohet si më poshtë vijon:

“12. Vlera e sipërfaqes kullimore të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga kërkuesi para hyrjes në fuqi të aktit të miratimit, të përmendur në shkronjat “a” e “b”, të pikës 9, të këtij vendimi, dhe derdhet në llogarinë bankare të bashkisë brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja kullimore, e cila do t’i nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi kullisor.”

5. Pika 17 ndryshohet si më poshtë vijon:

“17. Kur kërkesa bëhet sipas përcaktimit në pikën 15, ajo shqyrtohet nga Ministria e Mjedisit brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Pas këtij afati, ajo quhet e miratuar. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe ministria bëjnë përditësimet në kadastrën e pyjeve.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 436, datë 8.6.2016

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në aneksin nr. 3, “Lista e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa viza në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen fjalët “Bahrej” me dokumentin pasaportë, për periudhën 10 qershor – 1 nëntor 2016.”

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 437, datë 8.6.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Pika 1 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Bordet, këshillat dhe komisionet e njësisë të qeverisjes qendrore përbëhen nga përfaqësues të njësisë të qeverisjes qendrore dhe nga përfaqësues të tjerë, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës. Përfaqësues i njësisë së qeverisjes qendrore, në këto organe, emërohet punonjësi organik i njësisë.

Punonjësit e emëruar me kohë të pjesshme në përbërje të bordeve, këshillave apo komisioneve të njësisë të qeverisjes qendrore përfitojnë një pagesë për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në këto organe, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.”

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në ndarjen “Magjistratura” shtohet nëndarja “Bordi i redaktorëve”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Në ndarjen “Ministria e Shëndetësisë” shtohet nëndarja “Bordi i edukimit të vazhdueshëm”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;



c) Në ndarjen “Ministria e Drejtësisë”, masa e pagesës në nënndarjen “Këshilli Drejtues i Komitetit Shqiptar të Birësimeve” bëhet 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj;

ç) Në ndarjen “Ministria e Financave” bëhen këto ndryshime:

i) Emërtesa “Komisioni i Kualifikimit për Certifikimin e Auditëve të Brendshëm në sektorin publik”, bëhet “Komisioni i kualifikimit të audituesve të brendshëm”;

ii) Emërtesa “Bordi i Menaxhimit për Kontrollin e Brendshëm Financiar” bëhet “Bordi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik” dhe numri i anëtarëve të bordit bëhet “7 anëtarë”;

iii) Emërtesa “Komiteti i Auditimit të Brendshëm”, shfuqizohet.

3. Pas shkronjës “d”, të pikës 5, shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh. Masa e shpërblimit për anëtarin/kryetarin e Komitetit të Auditimit, që krijohet në njësinë publike, është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo mbledhje, por jo më shumë se 4 pagesa në vit.”.

4. Njësia e qeverisjes qendrore, që emëron përfaqësues të saj në bordet, këshillat dhe komisionet, cakton në një funksion/strukturë përgjegjëse me detyrën e mbajtjes së bazës së të dhënave të angazhimit të punonjësve në këto organe.

5. Efektet financiare, që krijohen nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për institucionet e përmendura në këtë vendim.

6. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

TABELA

Institucioni buxhetor	Emërtesa e Bordit/ Këshillit /Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Shpërblim kryetari (lekë)	Shpërblim anëtarë (lekë)
			Kryetar	Nr. i anëtarëve		
Ministria e Shëndetësisë	Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm	8	1	8	7 000	7 000
Shkolla e Magjistraturës	Bordi i redaktorëve	6	0	9	0	8 000

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I PARË
ÇËSHTJA HALIMI DHE TË TJERËT
KUNDËR SHQIPËRISË

(Ankimi nr. 33839/11)

VENDIM

Ky version u korrigjua më 26 prill 2016 sipas rregullit 81 të rregullores së Gjykatës

STRASBURG

7 prill 2016

Ky vendim është i formës së prerë. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Halimi dhe të tjerët kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Parë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Kristina Pardalos, *kryetare*,
Paul Mahoney,
Pauliine Koskelo, *gjyqtarë*,
dhe André Wampach, *zëvendësregjistrar i Seksionit*,
pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura më 15 mars 2016,

pasi ka vërejtur se çështja ligjore në fjalë në ankesën e mëposhtme, tashmë është objekt i praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të Gjykatës (shiko *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, 31 korrik 2012),

lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë ditë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një ankim (nr. 33839/11) kundër Republikës së Shqipërisë, dorëzuar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), nga 9 shtetas shqiptarë. Detajet e ankuesve përcaktohen në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur me vendimin.



2. Ankuesit u përfaqësuan nga z. S. Puto, avokate që ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agentja e saj, znj. A. Hicka nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Më 20 dhjetor 2013, ankimet iu komunikuan Qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHITJES

4. Më 30 maj 2003, Komisioni i Vlorës, i njohu ankuesve të drejtat për pronë të trashëguar për një sipërfaqe toke me përmasat 10,000 m². Duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

5. Deri më sot, nuk është paguar asnjë kompensim.

II. LIGJI PËRKATËS VENDAS

6. Ligji dhe praktika përkatëse vendase përshtohen në detaje, *inter alia*, në vendimin *Ramadhi kundër Shqipërisë* (nr. 38222/02, 13 nëntor 2007); *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, §§23–53, 31 korrik 2012) dhe i kohëve të fundit, *Sharra dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 dhe 2032/12, §§33–43, 10 nëntor 2015).

III. MATERIALET E KËSHILLIT TË EVROPËS

7. Materiale të lidhura me çështjen u referuan nga vendimet e kësaj Gjykate në çështjet *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §44, *Metalla dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 30264/08, 42129/08, 54403/08 dhe 54411/08, §§15–17, 16 korrik 2015); *Siliqi dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 37295/05 dhe 42228/05, §§12–13, 10 maj 2015); dhe *Karagozji dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 25408/06, 37419/06, 49121/06, 1504/07, 19772/07, 46685/07, 49411/07, 27242/08, 61912/08 dhe 15075/09, §§36–38, 8 prill 2014).

LIGJI

I. SHKELJET E PRETENDUARA TË NENEVE 6§1 DHE 13 TË KONVENTËS SI EDHE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS NË LIDHJE ME MOSZBATIMIN E VENDIMEVE TË FORMËS SË PRERË

8. Ankuesit pretendonin se ka pasur një shkelje të neneve 6§1 dhe 13 të Konventës, si edhe të nenit

1 të protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimeve vendase të formës së prerë, të cilat i akordonin atyre kompensim në vend të rikthimit të pronave të tyre.

Neni 6 § 1 i Konventës, për sa ka të bëjë me çështjen, parashikon si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave civile dhe detyrimeve ... çdo njeri ka të drejtën për një seancë... dëgjimore... nga [një] ... tribunal...”

Neni 13 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdo njeri të drejtat dhe liritë e të cilit, siç parashikohen në Konventë, janë thyer, do të përfitojë një kompensim efektiv përpara një autoriteti kombëtar, pavarësisht faktit se thyerja mund të jetë bërë nga persona me një pozicion zyrtar.”

Neni 1 i protokollit nr. 1 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe për kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e një Shteti për të zbatuar ligje, që ai i çmon të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

A. PRANUESHMËRIA

9. Qeveria nuk kontestoi pranueshmërinë e këtyre ankimeve.

10. Gjykata vëren se këto ankesa nuk janë të pabazuara, sipas kuptimit të nenit 35§3(a) të Konventës. Më tej, ajo vëren se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, ato duhen deklaruar të pranueshme.

B. Cilësitë

11. Qeveria nuk i diskutoi cilësitë e pakënaqësive të ankuesve dhe pranoi se ankimi ishte objekt i praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të Gjykatës për vendimin në çështjen *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër.

12. Për sa i përket gjetjeve të saj në çështjet e mëparshme kundër Shqipërisë, për të cilat Qeveria nuk paraqiti ndonjë argument për të garantuar distancimin e saj nga to (shiko midis të tjerave, *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§93–97 dhe referencat cituar në të; dhe, së fundmi, *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§49–51; *Metalla dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§ 29–31; *Siliqi dhe të tjerët*, cituar më sipër, §19), Gjykata konstaton se moszbatimi i vendimeve vendase të formës së prerë për kaq shumë vite nga ana e autoriteteve vendase, shkelte të drejtat e ankuesve sipas nenit 6§1 dhe sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të



Konventës.

13. Gjithashtu, Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka pasur dhe se vazhdon të mos ketë asnjë kompensim efikas vendas që do të mundësonte një korrigjim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për moszbatimin e tejzgjatur të vendimeve vendase të formës së prerë, të cilat akordonin kompensim. Kështu, ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës (shiko *Manushaqe Puton dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§72–84 dhe referencat cituar në të).

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6§1 E KONVENTËS NË LIDHJE ME KOHËZGJATJEN E PROCEDIMEVE

14. Ankuesit u ankuan sipas nenit 6§1 për kohëzgjatjen e procedurave si rezultat i moszbatimit të vendimeve të Komisionit.

15. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është e pabazuar sipas interpretimit të nenit 35§3(a) të Konventës. Më tej, ajo vëren se nuk është e papranueshme në ndonjë argument tjetër dhe për këtë arsye e deklaron atë të pranueshëm.

16. Gjykata argumenton se sipas gjetjeve në paragrafët 12–13 më sipër, çështja e kohëzgjatjes së procedurave duhet të konsiderohet se është përfshirë në çështjen e moszbatimit (shiko, për shembull, *Kutić kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, §34, GJEDNJ 2002–II, dhe *Popova kundër Rusisë*, nr. 23697/02, §44, 21 dhjetor 2006). Për këtë arsye, gjykata mendon se nuk është e nevojshme ta shqyrtojë këtë ankesë më veçantë.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

17. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Nëse Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve në të, dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktuese në fjalë lejon që të bëhet vetëm kompensim i pjesshëm, nëse është e nevojshme, Gjykata duhet të ofrojë kompensim të drejtë për palën e dëmtuar.”

A. DËMI

1. Parashtrimet e palëve

a) Ankuesit

18. Ankuesit bënë të njëjtat parashtrime si ato të përmbledhura në këtë vendim të Gjykatës në çështjen *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§57–58. Më specifikisht, ata kërkuan 823,071 euro (EUR) për vlerën e pronës së sipërfaqes së tokës me përmasë 10,000 m², bazuar në hartat e vlerësimit të vitit 2013. Ata kërkuan të aplikohet çmimi i referencës prej 11,523 lekësh shqiptarë (TË GJITHË)/m², siç tregohet në hartat e vlerësimit të

vitit 2013. Ata parashtruan se zotëronin të gjithë pronën. Ata kërkuan 135,000 euro për dëmin jomonetar.

b) Qeveria

19. Qeveria bëri të njëjtat parashtrime si ato të përmbledhura në vendimin e kësaj Gjykate në çështjen *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§69–71. Duke pasur parasysh faktin se në kohën e konfiskimit, sipërfaqja e tokës kishte qenë bujqësore, Qeveria propozoi se bazuar në hartat e vlerësimit të vitit 2014, duhej zbatuar çmimi i referencës për tokën bujqësore. Duke qenë se zona kadastrale ku pozicionohej prona nuk pasqyronte ndonjë çmim reference për tokën bujqësore, duhet të zbatohet çmimi i referencës për tokën bujqësore për një zonë tjetër kadastrale më të afërt, që është 280 TË GJITHË/m². Qeveria konfirmoi se ankuesit kishin të drejtë mbi të gjithë pronën.

2. Vlerësimi i Gjykatës

20. Gjykata shqyrtoi të njëjtat parashtrime të bëra nga palët në vendimin e saj në çështjen *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§78–87. Gjykata arriti në përfundimin se dëmi monetar duhet të përcaktohet bazuar në hartat e vlerësimit të pronës të vitit 2008 (shiko *Sharra dhe të tjerët*, cituar më sipër, §90; *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, § 125; dhe *Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (kompensim i drejtë), nr. 35720/04 dhe 42832/06, §§33–39, 7 dhjetor 2010). Gjykata nuk gjen asnjë arsye për t'u distancuar nga këto gjetje.

21. Gjykata vëren se autoritetet njohën të drejtën e ankuesve për kompensim në lidhje me tokën e ndërtimit dhe jo për tokën bujqësore, siç u argumentua nga Qeveria. Gjykata është e mendimit që ankuesve t'u jepet e drejta mbi të gjithë pronën.

22. Në lidhje me materialin në pronësi të saj, Gjykata e shikon të arsyeshme t'i akordojë ankuesve EUR 754,300 (shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind) për dëmin monetar dhe jomonetar.

B. Kostot dhe shpenzimet

23. Ankuesit kërkuan 1,000 euro për kostot dhe shpenzimet. Ata dorëzuan faturat përkatëse.

24. Duke cituar *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, § 72, 29 shtator 2009), sipas së cilës kostot dhe shpenzimet duhet jenë të paguara faktikisht dhe domosdoshmërisht dhe të jenë të arsyeshme, Qeveria ia la çështjen në mirëbesim Gjykatës për të vendosur shumën që do të akordohet për këtë rast.



25. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, “një ankues ka të drejtën të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet vetëm për atë kohë sa tregohet se këto janë bërë në të vërtetë dhe sepse kanë qenë të nevojshme, dhe se janë të arsyeshme për çdo shumë” (shiko *Gjyli kundër Shqipërisë*, cituar më sipër, §72). Në këtë këndvështrim, rregulli 60§§2 dhe 3 i rregullores së Gjykatës parashikon se ankuesit duhet të bashkëlidhin me kërkesat e tyre për kompensim të drejtë “çdo dokument mbështetës të lidhur me çështjen”. Nëse kjo gjë nuk realizohet, Gjykata “mund t’i kundërshtojë kërkesat plotësisht ose pjesërisht”.

26. Në lidhje me gjetjet e saj në paragrafët 12–13, natyra e përsëritur e ankesave të ngritura në ankimin e mësipërm, përfaqësimi i disa prej ankuesve nga i njëjti avokat dhe këndvështrimi i Gjykatës se shumica e kostove dhe shpenzimeve të kërkuara nuk ishin të justifikueshme për shumën, Gjykata e gjykon të arsyeshme t’i akordojë ankuesve 850 euro për kostot dhe shpenzimet.

C. INTERESI I PAPAGUAR

27. Gjykata e konsideron si të përshtatshme që norma e interesit të papaguar duhet të bazohet në normën marxhinale huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane, së cilës duhet t’i shtohen tre për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *I deklaron* ankimet e mbetura bazuar në nenet 6§1 dhe 13 të Konventës, si edhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, në lidhje me moszbatimin e vendimit vendas të formës së prerë dhe kohëzgjatjen e procedurave të pranueshme;

2. *Gjykon* se ka pasur një shkelje të neneve 6§1 dhe 13 të Konventës, si edhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në lidhje me moszbatimin e vendimeve vendase të formës së prerë;

3. *Gjykon* se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas kuptimit të nenit 6§1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave;

4. *Gjykon*:

a) Se Shteti i paditur duhet t’i paguajë bashkë ankuesit, brenda tre muajve¹, shumat e mëposhtme që duhet të konvertohen në vlerën monetare të Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e kompensimit:

i) 754,300 euro (shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind) plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme² për dëmin monetar dhe jo monetar.

ii) 850 euro (tetëqind e pesëdhjetë) plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për kostot dhe shpenzimet;

b) Se që nga përfundimi i periudhës tremujore të përmendur më sipër deri në kompensim, interesi i thjeshtë duhet të paguhet në shumat e mësipërme në një normë të barasvlershme me normën huadhënëse marxhinale të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës plus pikë tre për qind;

5. *Rrëzon* pjesën e mbetur të kërkesës së ankuesve për kompensim të drejtë.

Përgatitur në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 7 prill 2016, sipas rregullit 77§§2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

(*firamosur*)

André Wampach
ZËVENDËSREGJISTRAR

(*firamosur*)

Kristina Pardalos
PRESIDENTE

¹ Korrigjuar më 26 prill 2016: është hequr pjesa “që nga data në të cilën vendimi bëhet i formës së prerë në përputhje me nenin 44§2 të Konventës”.

² Korrigjuar më 26 prill 2016: është shtuar pjesa “plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme”.



SHTOJCA 1
LISTA E ANKUESVE

Emri dhe numri i çështjes	Emri i ankuesit (viti i lindjes)	Shteti ku banojnë	Përfaqësuar nga:	Data e prezantimit
<i>Halimi dhe të tjerët</i> nr. 33839/11	Eni Kokona (1976) Lindita Kokona (1976) Xhejni Kokona (1978) Nirvana Rradheshi (1951) Shpresa Halimi (1969) Diana Kaltani, mbiemri i vajzërisë Halimi (1936) Ermal Halimi (1959) Karolina Halimi (1935) Ariel Halimi (1963)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shtetet e Bashkuara Kanada Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Puto, avokat	14 mars 2011

VENDIM

Nr. 58, datë 10.6.2016

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT,
KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
SOCIALISTE NË QARKUN VLORË, PËR
PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË
NJOFTUAR NGA KUVENDI I
SHQIPËRISË PËR SHKAK TË
MBARIMIT TË MANDATIT TË
DEPUTETIT TË Z. KOÇO KOKËDHIMA**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 10.06.2016, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi	kryetare,
Denar Biba	Zëvendëskryetar,
Edlira Jorgaqi	anëtare,
Gëzim Veleshnja	anëtar,
Hysen Osmanaj	anëtar,
Klement Zguri	anëtar,
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Socialiste, në qarkun e Vlorës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, për shkak të mbarimit të mandatit të deputetit të z. Koço Kokëdhima.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, neni 175, pika 2 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, ka njoftuar KQZ-në se, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 23, datë 3.6.2016, ka vendosur “Konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Koço Kokëdhima”. Sipas nenit 71, pika 2, germa “c”, e Kushtetutës, konstatimi i papajtueshmërisë me mandatin, shkakton ndërprerjen e këtij mandati. Për këtë arsye, nëpërmjet kësaj shkrese, Kuvendi i Shqipërisë njofton KQZ-në për krijimin e vakancës të mbarimit të mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Koço Kokëdhima, deputet i zonës zgjedhore qarku Vlorë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënie e mandatit kandidatit të radhës, në listën shumëemërore të së njëjtës parti politike, në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 31, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore qarku Vlorë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste për zonën zgjedhore qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 6 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumëemërore e Partisë



Socialiste për qarkun Vlorë, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Edi Rama, me numër rendor 2 (dy) Valentina Leskaj, me numër rendor 3 (tre) Koço Kokëdhima, me numër rendor 4 (katër) Luiza Xhuvani, me numër rendor 5 (pesë) Fatmir Toçi, me numër rendor 6 (gjashtë) Andrea Marto.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 159, datë 1.12.2014, ka ndërprerë mandatin e deputetes znj. Luiza Xhuvani dhe ia ka kaluar kandidatit në listën shumemërore me numër rendor 9 të Partisë Socialiste qarku Vlorë, znj. Mira Qemal Shehu.

Me njoftimin e mbarimit të mandatit të deputetit, z. Koço Kokëdhima, KQZ-ja ka detyrimin ligjor të marrë vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën e kandidatëve të listës shumemërore, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun e Vlorës i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, fjalia e parë. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, fjalia e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Socialiste në Zonën Zgjedhore qarku Vlorë.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013, "Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane" për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013", ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore.

Sipas listës shumemërore të Partisë Socialiste për qarkun Vlorë, kandidati i radhës është kandidati me numër rendor 7 (shtatë), z. Edmond Dhimitraq Leka. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm, rezulton se personit të cilit do t'i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga ndërprerja e mandatit të z. Koço Kokëdhima, është z. Edmond Dhimitraq Leka, i cili renditet përkatësisht me numër rendor 7 (shtatë).

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Në këto kushte, z. Edmond Dhimitraq Leka, duhet të depozitojë formularin e vetëdeklarimit në KQZ, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, deputet i Kuvendit.

Duke qenë se z. Edmond Dhimitraq Leka është subjekt deklarimi pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, kjo e fundit me shkresën nr. 2602, datë 9.6.2016, i ka dërguar KQZ-së formularin e vetëdeklarimit të z. Edmond Leka dhe thekson se kanë filluar procedurën e verifikimit të subjektit deklarues.

Në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", KQZ-ja bëri publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit dhe verifikimin e të dhënave në këtë formular.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Edmond Leka, rezulton se nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në këto kushte, KQZ-ja, referuar kreut V, pikës 2, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", duhet të marrë vendim për dhënie mandati, si dhe njëkohësisht të vazhdojë procedurat e mëtejshme për realizimin e verifikimit.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 158 lekë